

VENDIM
Nr. 49, datë 25.2.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 261, DATË 17.11.2020,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR TRANSFERIMIN E PROKURORËVE
NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE”, TË NDRYSHUAR, TË
KËSHILLIT**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës; në nenet 42 dhe 43, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenet 164, 166, 184, germa “c” dhe 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

I. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 261, datë 17.11.2020, “Për miratimin e rregullores ‘Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, të ndryshuar, të Këshillit.

II. Pas nenit 6, të Rregullores, të shtohet neni 6/a, me këtë përmbajtje:

“1. Këshilli merr masa që pozicionet që ka shpallur të lira, t’i publikojë në faqen e tij zyrtare të internetit.

2. Në momentin që një prokuror aplikon për një pozicion në procedurën e shpallur, Këshilli duhet që ta bëjë publike, po në faqen zyrtare të internetit, emrin e prokurorit dhe pozicionin ku ai ka aplikuar. Ky publikim duhet të jetë sa më i shpejtë, por jo më vonë se 24 orë nga momenti i aplikimit.

3. Me përfundimin e periudhës së aplikimit, prokurorët që kanë aplikuar brenda afatit, kanë të drejtë që, nëpërmjet një kërkesë, të ndryshojnë përzgjedhjen e pozicioneve ku kanë aplikuar. Kjo mundësi vlen deri në 48 orë, pas përfundimit të afatit të aplikimit. Kjo mundësi pasqyrohet qartë në shpalljen e procedurës së lëvizjes paralele.

4. Relatori i caktuar për shpalljen e procedurës së lëvizjes paralele është përgjegjës për zbatimin e këtyre parashikimeve. Në realizimin e kësaj detyre, ai ndihmohet nga strukturat përkatëse të Këshillit.”.

III. Neni 9, pika 2, e rregullores ndryshon si vijon:

“2. Relatori i caktuar me short nga Komisioni, për shpalljen e pozicioneve të lëvizjes paralele, ndjek procedurat përkatëse, deri në momentin kur Këshilli me vendim verifikon plotësimin e kushteve ligjore për të gjithë prokurorët që kanë kandiduar. Më tej, për çdo procedurë transferimi nëpërmjet lëvizjes paralele, Këshilli cakton një relator me short.”.

IV. Pas nenit 44, të rregullores të shtohet neni 44/a, me këtë përmbajtje:

“Në rastin kur kandidati që është renditur i pari, përpara se të transferohet, heq dorë nga kandidimi për atë pozicion, përzgjedh një tjetër pozicion ose për arsye të ndryshme, parashikuar nga legjislacioni në fuqi, humbet statusin e magjistratit, atëherë Komisioni realizon dhe i propozon Këshillit një renditje tjetër të kandidaturave, sipas parashikimeve ligjore.”.

V. Ndryshimet dhe shtesat sipas këtij vendimi nuk zbatohen për procedurat e mëparshme të lëvizjeve paralele që janë ende në proces.

VI. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot, më 25.2.2026.

KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË
Mirela Bogdani